



Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën 2. 2 të punësimit dhe rritjes së subjekteve juridike, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datën **16.04.2018** bën

## **SHPALLJE PUBLIKE**

**për**

### **punëdhënësit e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe organizatave qytetare**

U bëhet thirrje punëdhënësve të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjeve sociale dhe organizatave qytetare, të cilët dëshirojnë që ta zgjerojnë dhe zhvillojnë biznesin e tyre me hapje të reja të vendeve të punës, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit të APRM-së.

Masa e mbështetjes ka të bëjë me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe ndërmarrjeve sociale (ndërmarrjet dhe organizatat qytetare të cilat në mënyrë parësore janë të orientuara nga qëllimet sociale dhe përfitimi i të cilave është të riinvestohet për sigurimin e këtyre qëllimeve nëpërmjet punës afariste ose investimit brenda shoqërisë) dhe organizatave qytetare të cilat i plotësojnë kushtet siç vijojnë:

- Numri i përgjithshëm i punëtorëve për kohë të pacaktuar në ditën e aplikimit nuk duhet të jetë më i ulët se numri mesatar i personave të punësuar në kohë të pacaktuar gjatë vitit kalendarik paraprak;
- Në ditën e aplikimit t'i ketë shlyer të gjitha detyrimet në bazë tatimore dhe të kontributeve të sigurimit të detyrueshëm social;
- Të mos ketë humbje financiare gjatë vitit paraprak;
- Punëdhënësi duhet patjetër të ketë së paku një person të punësuar në vazhdimësi më së paku gjashtë muaj para aplikimit, me përjashtim të organizatave qytetare të cilat në momentin e aplikimit mund të mos kenë person të punësuar;
- Numri i personave të sapopunësuar me këtë masë nuk mund të jetë më i madh se 50 për qind nga numri mesatar i personave të punësuar në kohë të pacaktuar gjatë vitit kalendarik paraprak.  
Punëdhënësi i cili e ka të punësuar një person dhe te organizatat qytetare të cilat nuk kanë të punësuar asnjë person, numri maksimal i punësimeve të mbështetura është vetëm një person.
- Programi nuk do të mbështesë subjekte juridike të regjistruara pas datës 01.07.2017. Po ashtu shfrytëzuesit (subjektet juridike) e këtij programi nuk do të mund të shfrytëzojnë masë tjetër në bazë të njëjtë të përcaktuar me ligj të posaçëm ose në bazë të programeve të tjera të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe organeve të tjera kompetente.

(Agjencia e Punësimit në mënyrë zyrtare do t'i sigurojë të dhënat e lartpërmendura për subjektet juridike të cilat do të aplikojnë në shpalljen zyrtare).

Mbështetja financiare për hapjen e një vendi të ri të punës (më së shumti hapja e pesë vendeve të reja të punës për secilën firmë) përfshin pagesën e mjeteve të pakthyeshme për furnizime me pajisje ose materiale të reja në një shumë prej 153.750 denarë (për hapjen e secilit vend të ri të punës), me detyrimin që punëdhënësi të sapopunësuarit t'i mbajë në marrëdhënie pune me orar të plotë pune më së paku 12 muaj (për personat deri 29 vjet) ose 92.000 denarë (për hapjen e secilit vend të ri të punës), me detyrimin që punëdhënësi të sapopunësuarit t'i mbajë në marrëdhënie pune me orar të plotë pune më së paku nëntë muaj (për personat deri 29 vjet) nga dita e punësimit, pa e zvogëluar numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kohë të pacaktuar).

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen më konkretisht me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet punëdhënësve dhe APRM-së

Punëdhënësit e interesuar mund të aplikojnë deri në plotësimin e projektit të paraparë për shfrytëzuesit.

Punëdhënësit e interesuar mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet në qendrat e punësimit çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 si dhe në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë ([www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ([www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)).

AGJENCIA E PUNËSIMIT

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË